

RELACION TEKNIK

OBJEKT : PASTRIM ,GRUMBULLIM DHE TRANSPORTIMI I

MBETURINA VE NE TERRITORIN E BASHKISE BELSH

1. Dispozitat e pergjithshme te modelit te llogaritjes Sistemi standard i llogaritjes se kostos per menaxhimine mbetjeve per Bashkine Belsh duhet te bazohet ne te pakten 2 qendrat e kostove te meposhtme':

1. Te dhenat e pergjithshme per njesine administrative apo zonen e sherbimit
2. Kostot operative (mirembajtje, transport dhe personel

1.1 Te dhenat e pergjithshme per zonen administrative

Qellimi i ketij blloku eshte te percaktoje situaten dhe vleresojte nevojat per investime kapitale, operacione, personel dhe ceshtje te tjera administrative

Variablat kryesore, te cilat duhet te merren ne konsiderate per kete bllok jane:

- a) tipologjia e NjQV-se
- b) nr. I popullsise,
- c) vizitoret dhe turistet
- d) distancat rrugore,
- e) sasia e mbetjeve te gjeneruara.

Me poshte, ne do te ofrojme nje shpjegim te ndryshueshmerise se cdo variabli:

- a) Tipologjia i NjQV-se. Konsiston ne percaktimin e NJQV-se ne urbane dhe rurale. Ky variabel eshte i rendesishem per percaktimin (hazuar ne Strategjine Kombetare te Mbetjeve dhe Planin Kombetar te Mbetjeve) e sasise se mbetjeve te gjeneruara, tipin e kamioneve, distancat, personelin dhe te gjitha kostot e lidhura me keto.
- b) Popullsia (Nr. ibanoreve).

Popullsia e Bashkise Belsh perbehet Bashkia Belsh perbehet nga 4 Njesi

Administrative dhe 35 fshatra:

Per proceduren e pastrimit do te perfshihet

Nën-zona e Parë: karakterizohet si zona urbane e NJA Belsh, fshatrat Hyse, Stanaj, Qafshkall, Trojasme rreth 3,000 banorë dhe ku janë përqëndruar pjesa më e madhe e bizneseve, shkollave dhe institucioneve të tjera

Nën-zona e Dytë: karakterizohet si zona rurale e NJA Belsh ku futen fshatrat (Seferan, Cep, Shkozet, Gradisht, Dushk, Marinze dhe Shkendi) me rreth 11,400 banorë dhe ku ndodhen pak bizneseve dhe institucione të tjera.



Nën-zona e tretë: karakterizohet si zona rurale e NJA Kajandhe bëjnë pjesë fshatrat Kajan, Lisaj, Gjinuk, Turbull, Gjolene, Cestije, Dragot fermë, Dragot kooperativë, Merbojë, Idriz, dhe Hardhi. Ka rreth 6,800 banorë.

Nën-zona e katërt: karakterizohet nga zona rurale e NJA Fierzë ku bëjnë pjesë fshatrat Fierzë, Cërragë dhe Kosovë me rreth 4,000 banorë.

Nën-zona e pestë: karakterizohet nga zona rurale e NJA Rrasë ku bëjnë pjesë fshatrat Rrasë e poshtme dhe e sipërme, Shegas dhe Guri i bardhë me rreth 2,370 banorë.

Nën-zona e gjashtë: karakterizohet nga zona rurale e NJA Grekan ku bëjnë pjesë fshatrat Grekan, Dëshiran, Guras dhe Rrenas. Tipologjia e banesave është private (një e dy katshe) me 5070 banorë

Gjenerimi i mbetjeve nga çdo zonë mbetjesh

Referuar shpërndarjes së bizneseve dhe institucioneve sipas çdo njësie administrative dhe gjenerimit ditor të mbetjeve nga çdo konsumator, rezulton që gjenerimi i mbetjeve ditor, në herë mbledhje dhe ai vjetor në çdo zonë mbetjesh të jetë si më poshtë:

Nr	Emertimi Zones 2019	Popullsia sipas GJC	Popullsia e korrektuar	Norma e gjenimit	Frekuenca mbledhjes mbetjeve dite ne jave	Gjenerimi (kg/dit)	Gjenerimi (ton/dit)	Gjenerimi ton/here	Mbetje ton/vit
2019-2020									
1	Belsh urban	2,943	2,148.18	0.55	7	1181.50	1.18	1.18	431.25
2	Kajan	6,817	4,792.60	0.3	1	1437.78	1.44	10.06	524.79
3	Fierz	4,039	2,657.20	0.3	1	797.16	0.80	5.58	290.96
4	Rrasë	2,370	1,826.80	0.3	1	548.04	0.55	3.84	200.03
5	Grekan	5,067	3,716.70	0.3	1	1115.01	1.12	7.81	406.98
6	Belsh Rural	11394	8,316.79	0.3	2	2495.04	2.50	17.47	910.69
Totali		32,630.00	23,458.26	2.05	13.00	7,574.52	7.57	45.93	2,764.70
2021-2024									
1	Belsh	2,943	2,148.18	0.55	7	1181.50	1.18	8.27	431.25
	Kajan	6,817	4,792.60	0.3	2	1437.78	1.44	5.03	524.79
2	Fierz	4,039	2,657.20	0.3	2	797.16	0.80	2.79	290.96
3	Rrasë	2,370	1,826.80	0.3	2	548.04	0.55	1.92	200.03
4	Grekan	5,067	3,716.70	0.3	2	1115.01	1.12	3.90	406.98
5	Belsh rural	11394	8,316.79	0.3	2	2495.04	2.50	8.73	910.69
Totali		32,630.00	23,458.26	2.05	17.00	7,574.52	7.57	30.65	2,764.70